| 17.30 | Vërtetimet për shtëpitë e djegura të patrajtuara | Lirohen nga pagesa |
| 17.31 | Vërtetimet për shtëpitë e djegura të trajtuara | 1.00 € |
| 17.32 | Vërtetimet për lëndët në procedure shqyrtimi | 1.00 € |
| 17.33 | Vërtetim për vjetërsi të banesës | 2.00 € |
| 17.34 | Vërtetim për distancën e lokaleve për lojëra të fatit me institucionet shkollore | 500.00 € |
| 17.35 | Vendimi për vendosje të trafos nga Operatori për TU TS dhe mjete të telekomunikimit | 5.00 € |

**Neni 20**
**Taksat për Dhënjen e Lejes Mjedisore Komunale**

Në bazë të UA nr.01/2017 Taksën për tu pajisur me LMK aplikuesi duhet të paguaj, për projektet:
Në vlerën inventive të projektit deri 25,000 € paguhet tarifa në vler prej (50 €);
Në vleren investive të projektit deri mbi 25,000€ paguhet tarifa 0.2% të vlerës investive të projektit.

**Projektet që i nënshtrohen Lejes Mjedisore**

1. Autoserviset.
2. Autolarjet.
3. Autoserviset me automjete jashtë pordorimit deri në 20 copë.
4. Stacionet e karburantëve të gasit (GLN) deri $5m^{3}$.
5. Stacionet e karburantëve me kapaciete deri $50m^{3}$.
6. Sharrë për lënd drunore.
7. Fabrika për përpunim druri,mobilieri,tapiceri deri $1000m^{3}$/vit.
8. Furrat për prodhim të bukës dhe produkteve të miellit.
9. Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit dhe ujrave të zeza në gjatësi deri 5km.
10. Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellsit në gjatësi deri 5 km.

11. Riparimi i rrugëve urbane egzistuse dhe ndërtimi i aksëve të reja rrugore (me gjatësi deri 5km).
12. Mishtoret.
13. Prodhimi i gëlqeres së shuar.
14. Prodhimi i betonit dhe elementeve parafabrikate, pllakave etj. Me kapacitet të projektuar deri në 2 $m^{3}$ beton/ orë.
15. Qendra për grumbullimin e mbeturinave nga ndertimi dhe demolimit, për komunat të cilat kanë më pak se 60,000 banorë.
16. Rritja artificiale e peshkut në hurdha, me sipërfaqe deri në 300 $m^{2}$.
17. Pishinat, pa objekte hotiliere dhe objekteve përcjellse.
18. Punishtet për përpunim të mermerit.
19. Ndërtimi i objekteve të banimit kolektiv dhe të shërbimëve (hoteliere, tregtare, komerciale, afariste etj) me sipërfaqe bazë mbi $450m^{2}$ ose në sipërfaqen totale të objektit mbi $1,500m^{2}$
20. Vepromtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri $100m^{3}$ ose 40 ton/vit.
21. Depoja për plehëra kimike dhe pesticide.
22. Objekte shërbyse për ushqime (qebabtore, ëmbëltore,gjelltore, restorante etj).
23. Vendet apo qendrat për mbledhjen dhe grumbullim të mbeturinave, ku magazinohen mbeturinat inerte (plastikë, letër dhe qelq), në sasi deri 30 ton.
24. Impiantet për rritjen intenzive të shpenzëve, bagtive të imta dhe të mëdha që kan më pak se: 5,000 shpend; 250 derra; 50 gjedha; 500 bageti të imta.
25. Paisjet për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë, me fqi instaluse deri 100Kw/orë.
26. Sistemet solare me sistemet fotovoltaike të prodhimit të energjisë/ avullit, deri 100Kw/ orë
27. Stacionet e telefonis mobile.
28. Vendet e tregtimit të kafshëve në vende të hapura dhe mbyllura.
29. Pikat e magazinimit dhe tregtimit të materialeve të ndertimit.

30.Qendra zejtare.
31.Serviset (servisimi i paisjeve teknike dhe elektronike).
32.Studiot fotografike.
33.Prodhimi i dyerve dhe dritarëve të plastikës.

**Projektet që lirohen nga Leja Mjedisore**

Projektet publike:

1. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitimet e tyre në gjatësi deri 5 km
2. Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rehabilitim i ujësjellësve ekzistues në gjatësi deri 5 km
3. Riparimi i rrugëve urbane egzistuse dhe ndertimi i aksëve rrugore (me gjatësi deri 5km)

## Neni 21
## DREJTORIA PËR GJEODEZI KADASTER DHE PRONA

### Taksat për shërbimet e Kadastrit Gjeodezisë, Pronës dhe Banimit

1.Taksat për Ofrimin e Shërbimeve të Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës duhet të bazohen në përputhshmëri me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.04/2024 për Tarifat për Produktet Shërbimet Kadastrale Gjeodezike dhe Regjistrim të Pronave si dhe Vendimin Nr.53/24, të datës 02.08.2024 të nxjerrë nga Zv.Drejtori Ekzekutiv në AKK për caktimin e listës së produkteve dhe shërbimeve të cilat ofrohen nga Zyrat Kadastrale Komunale.

## Neni 22
## DREJTORIA PER BUJQESI, ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

1. **Tarifa per nderrimin e destinimiti perhershem te tokes bujqesore;**

**Tabela nr.18**

| **Nr.** | **Emertimi i kategorise se tokes** | **Vlera** |
|---|---|---|
| 18.1 | Kategoria e pare e tokes\ klase e I-IV | 1.00 € \ m$^2$ |
| 18.2 | Kategoria e dyte e tokes \ klase e V-VI | 0.75 € \ **m$^2$** |
| 18.3 | Kategoria e trete e tokes \ klase e VII-VIII | 0.50 € **\m$^2$** |

Për ndërrimin e përkohshëm të destinimit të tokes bujqesore do te paguhet kompensimi 20% nga taksat e destinimit te perhershem, pervec nese me ligj nuk eshte percaktuar ndryshe.

2. **Tarifa per sherbimet profesionale ne perzgjedhjen dhe damkimin e trungjeve dhe**

**leshimin e lejeve per prerje ne pyjet private dhe publike;**

2.1 Damkimi i trungjeve per prerje ne pyjet private, behet nga Agjencioni i Pyjor i Kosoves ne pajtim me planet vjetore te menaxhimit dhe ne pajtim me mundesite vjetore te shfrytezimit te ngastrave.

2.2 Te gjitha procedurat e leshimit te lejes per prerje ne pyjet private duke perfshire shqyrtimin e kerkeses, dhenien e lejes per prerje, shenjimin e asortimentit per transport dhe leshimin e flet percjelljes udhehiqen nga Autoriteti Pyjor Komunal.

2.3 Per perzgjedhjen, damkimin dhe leshimin e lejeve per prerjen e trungjeve te klasifikuara si asortiment teknik (industrial) dhe per trungje te klasifikuara si dru per djegie, do te zbatohen tarifat si ne vijim:

Taskat per sherbimet profesionale per prerje te pyjeve private, dhenen e pelqimeve, vertetimeve nga lemia e bujqesise dhe pasurive tjera bujqesore:

**Tabela nr.19**

| Nr. | Kategorizimi i dokumentit | Viera ne € |
|---|---|---|
| 19.1 | Fletepagesa per damkosje te druve ne pyje private me v=7m$^3$ | **1.50 €\m$^3$** |
| 19.2 | Fletepagesa per damkosje te druve ne pyje private me v =mbi 7m$^3$ | **2.00 € \ m$^3$** |
| 19.3 | Fletepagesa per dru teknik (industrial) per m$^3$ | **3.00€ \ m$^3$** |
| 19.4 | Fletepagesa per pyje publike- dru te thata-holla d=7cm | **11.00€\ m$^3$** |
| 19.5 | Fletepagesa per pyje publike-dru te thata- trasha mbi d=7cm | **15.00 €\ m$^3$** |
| 19.6 | Per punen e komisionit ne vleresimin e demit, Pyllit, Vreshtave, Pemishteve, Kulturave Lavertare, Bagetise, dhe pasurive tjera, | **10.00 €** |
| 19.7 | Vertetim per shitjen e prodhimeve bujqesore ne treg per nje vit | **15.00 €** |
| 19.8 | Vertetim per Bujqesi- per rregullimin e vizave turistike | **5. 00 €** |
| 19.9 | Vertetimi per bartjen e kafsheve per koke | **1.00€** |
| 1910 | Trajtimi i qenve endacak dhe shtepiak me kerkese te pronarit | **10.00 €** |
| 19.11 | Vertetim per te deshmuar se nje fermer merret apo eshte marre me aktivitet bujqesore | **3.00€** |
| 19.12 | Per leshimin e ç'do vertetimi e qe nuk eshte parapare keto tarifa dhe ngarkesa | **3.00€** |

1. **Taksa vjetore per shfrytezimin e kullotave per bagëtitë në pyje dhe toka pyjore publike eshte:**

**Tabela nr.20**

| Nr. | Lloji i bagetise | NB/koke | EURO/koke |
|---|---|---|---|
| 20.1 | Gjedhe mbi nje vit | **1** | **1.20 €\cope** |
| 20.2 | Viça | **0.45** | **0.54 €\cope** |
| 20.3 | Dele | **0.18** | **0.22 €\cope** |
| 20.4 | Qengja | **0.1** | **0.12 €\cope** |
| 20.5 | Kuaj dhe gomare | **1** | **1.20 €\cope** |
| 20.6 | Derra | **0.3** | **0.36.€\cope** |
| 20.7 | Rosat | **0.014** | **0.02 €\cope.** |
| 20.8 | Dosat | **0.5** | **0.60€\cope** |

2. Perpos taksave dhe ngarkesave te caktuar ne nenin 22, paragrafi 1, 2, 3, te kesaj rregulloreje do te aplikohen edhe taksat qe caktohen nga Ministria perkatese me aktet nen ligjore te aplikueshme.

## Neni 23
## QENDRA PËR PUNË SOCIALE

### Taksat dhe tarifat për shërbimet e Qendrës për Punë Sociale

1. Taksat dhe tarifat për ofrimin e shërbimeve nga Qendra për Punë Sociale, janë të përcaktuara në tabelën nr. 21 të kësaj Rregulloreje.

**Tabela nr. 21**

| | | |
|---|---|---|
| 21.1 | Vërtetimi për posedim të zotësisë së veprimit për paisje për leje të armës | 8.00 € |
| 21.2 | Vërtetimi për posedim të zotësisë së veprimit për punësim | 1.00 € |
| 21.3 | Vërtetim për lirim nga shtëtësia e Kosovës që nuk ka obligime financiare | 5.00 € |
| 21.4 | Vërtetimi për pranim të shtetësisë së Kosovës | 1.00 € |
| 21.5 | Vërtetimi për palën se nuk është shfrytëzues/shfrytëzuese i/e ndihmës sociale | 1.00 € |
| 21.6 | Vërtetimi për palën se ka qenë shfrytëzues/shfrytëzuese i/e ndimës sociale | 1.00 € |
| 21.7 | Vërtetimi për palën se nuk është shfrytëzues/shfrytëzuese i/e ndihmës sociale për shtetë të jashtëm. | 5.00 € |
| 21.8 | Vërtetim për rexhistrim të mëvonshëm të fëmijës | 3.00 € |
| 21.9 | Pëlqim për martësë para moshës madhore | 5.00 € |
| 21.10 | Vërtetim që është duke u kujdesur për fëmijën | 1.0 |

2.Dispozitat lehtësuese për lirim nga tarifat në qendrën për punë sociale do të aplikohen në bazë të nenit 61 të Ligjit për Shëndetësi me Nr. 04/L-125.
3. Lirimi nga taksat sipas kësaj regulloreje, bëhet pasi që pala të prezantoj dëshmi valide me shkrim për statusin përkatës.

## Neni 24
## Gjobat lidhur me mos paraqitjen e lindjes dhe vdekjes

1. Çdo preson fizik përgjegjës i cili nuk paraqet lindjen e fëmijës në territorin e Komunës në afatin prej tridhjete (30) ditësh nga data e lindjes kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në shumë prej njëzete euro (20 €).

2. Çdo person fizik përgjegjës i cili nuk e lajmëron vdekjen e personit të regjistruar me vendbanim në Komunë brenda tridhjete (30) ditësh nga data e vdekjes se personit brenda Republikës së Kosovës, apo brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh për vdekjet e ndodhura jashtë Republikës së Kosovës, kryen kundërvajtje të lehtë dhe nga Komuna i shqiptohet gjobë në shumë prej pesëdhjete euro (50 €).

**Neni 25**
**Gjobat lidhur me vendbanimin dhe vendqëndrimin**

1.Çdo person fizik që ka vendbanim apo vendqëndrim në Komunë dhe i cili nuk i ndërmerr veprimet e parapara në këtë paragraf, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej tetëdhjetë (80 €):
2. nuk e lajmëron ndryshimin e vendbanimit dhe vendqëndrimit brenda territorit të komunës, brenda tetë (8) ditësh nga ky ndryshim;
3. nuk e lajmëron largimin nga Republika e Kosovës, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë; dhe
4. nuk e lajmëron kthimin në Republikën e Kosovës, me qëllim të qëndrimit për më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.

**Neni 26**
**Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës për ushtrimin e veprimtarisë afariste**

1. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taksën vjetore në emër të ushtrimit të veprimtarisë afariste brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej pesëdhjete euro (50 €).

2. Çdo shoqëri tregtare që nuk vepron si biznes individual, i cili nuk e paguan taken vjetore në emërtë ushtrimit të veprimtarisë afariste të përcaktuar me këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej pesëdhjetë euro (50 €).

**Neni 27**

**Gjobat lidhur mos pagesën e taksës komunale mbi mjetet motorike**

1. Çdo person fizik i cili nuk e paguan taksen komunale per mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej njëzet euro (20 €).

2. Çdo shoqëri tregtare që vepron si biznes individual, i cila nuk e paguan taksën vjetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej katërdhjetë (40 €) euro.

3. Çdo shoqëri tregtare apo person tjetër juridik i cili nuk vepron si biznes individual, që nuk e paguan taksën vjetore për mjetin motorik brenda afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë në shumë prej njëqind euro (100 €).

**Neni 28**
**Gjobat për mos pagesën e taksës komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje**

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksen komunale për ndërhyrje në infrastrukturë komunale dhe taksës komunale për rrënim të objekteve pa leje sipas afatit të përcaktuar në këtë Rregullore, kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobë si në vijim:
1.1. për personin fizik - njëqind euro (100 €);
1.2. për person fizik që ushtron biznes individual - dyqind euro (200 €); dhe
1.3. për personin juridik - treqind euro (300 €).

**Neni 29**
**Gjobat lidhur me mos pagesën e taksës komunale për vendosjen e panove reklamuese**

1. Çdo shoqëri e cila nuk paguan taksë komunale mbi vendosjen e panove reklamuese e cila kalon shumën prej njëqind euro (100 €) sipas afateve të përcaktuar nga kjo Rregullore kryen kundërvajtje te lehtë dhe Komuna i shqipon gjobë si në vijim:
1.1. Me gjobë mandatore në shumën prej 150€, do të gjobiten të gjithë personat fizik dhe juridik.

**Neni 30**
**Gjobat lidhur me taksat komunale për vendosjen e objekteve në hapësirat publike**

1. Çdo person i cili nuk e paguan taksen komunale për vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirën publike sipas dispozitave ët kësaj Rregullore, e cila kalon shumën mbi njëqind euro (100€), kryen kundërvajtje të lehtë dhe Komuna i shqipton gjobe si në vijim:
1.1. Me gjobë mandatore në shumën prej 150€, do të gjobiten të gjithë personat fizik dhe juridik.

**Neni 31**
**Pagesat e gjobave dhe çështjet tjera mandatore**

**1.** Gjobat e përcaktuara me këtë Rregullore paguhen brenda pesëmbëdhjete (15) ditëve nga datat e shqiptimit të tyre, por jo me vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e shqiptimit të tyre.
**2.** Në rast të pagimit të gjobës së shqiptuar me këtë Rregullore brenda afatit tridhjetë (15) ditësh, i dënuari lirohet nga pagimi pesëdhjetë përqind (50%) të shumës së gjobës së shqiptuar.
**3.** Presoni ndaj te cilit shqiptohet gjoba sipas dispozitave të kësaj Rregullore ka të drejtën e ankesës, sipas afateve dhe procedurave të parapara në legjislacionin në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.
**4.** Procedurat kundërvajtjes zhvillohen nga Komuna në përputhje me legjislacionin ne fuqi për kundërvajtjet.

**DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUDNIT**

**Neni 32**

Dispozitat e Rregulloreve të miratuara nga Kuvendi i Komunal i Mitrovicës se Veriut te cilat rregullojnë një fushë të caktuar (të veçant) janë në epersi para dispozitave te kesaj Rregullore

**Neni 33**

Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj rregullore është në kundërshtim me ndonjë dispozitë të Ligjit apo të udhëzimeve administrative të nivelit qendror që i rregullojnë këto lëmi, atëherë respektohen dispozitat e Ligjit, përkatësisht Udhëzimeve të nivelit Qendror.

**Neni 34**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe pas publikimi në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Veriut.

**Mitrovicë Veriore** **Nedzad UGLJANIN**

**Kryesues i Kuvendit në Komunën e Mitrovicës Veriore**

**Dorëzohet:**
**1x1 Kryesuesit të Kuvendit**
**1x1 MAPL**
**1x1 Arkivit**
**Kopje: Kryetarit të Komunës**
**Të gjitha Drejtorive**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 2.2
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 05-8313
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages: -35-
Data: / Datum: / Date: 30/10/2025
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstvoa-Ministry of Health
Departamenti Ligjor/Pravni Departament/Legal Departament

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 31.10.2025
Njësia organizative: -VI- | Nr. i Lëndës: 43-261 | Vlera: 14

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Z. Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor | |
| Kopje: | Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Veriut<br>Kryesuesi i KK – Mitrovica e Veriut<br>Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL<br>Z. Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm MAPL<br>Z. Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit<br>Z.Ramadan Potera, Zyrtar i lartë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktëve të Komunës<br>Dr. Merita Vuthaj, Drejtor i DShShShP<br>Dr.Shaban Osmanaj, Udhëheqës i Divizionit të kujdesit parësor | |
| Përmes: | Dr. Arsim Berisha, Zv.Ministër i Shëndetësisë<br>Z. Jahë Gecaj, U.D. Sekretar i Përgjithshëm në MSH | |
| Nga: | Afërdita Hoxha, Drejtor i Departamentit Ligjor në MSH | Date: 29/10/2025 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | Kadrije Sherifi, Udhëheqëse e Divizioni për Mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe bashkëpunimin ndër-institucional/MSh | |
| Lënda: | Shqyrtim i ligjshmërisë e aktit të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut | |
| Lloji i aktit: | Rregullore Komunale Nr.06/2025 për taksa, tarifa dhe gjobat komunale të Komunës së Mitrovicës së Veriut | |

I nderuar z.Hetemi,

Ministria e Shëndetësisë në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 Për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e

Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë.

Rregulloren Komunale Nr.06/2025 për taksa, tarifa dhe gjobat komunale të Komunës së Mitrovicës së Veriut.

Pas shqyrtimit të Rregullores Nr.06/2025 për taksa, tarifa dhe gjobat komunale të Komunës së Mitrovicës së Veriut, ju njoftojmë se është në harmoni me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2024 - Bashkëpagesat për shërbime shëndetësore dhe Udhëzimin Administrativ Nr.04/2013 Certifikatat shëndetësore.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit 02 K07/1 Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No. 1502-1/2025
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages 7 Data / Datum / Date 29.05.2025
Dalëse PRISHTINË/A

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date 29.05.2025
Njësia organizative -VI- | Nr. i Lëndës 43-261 | Vlera 14

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada – Government***

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Erden Atiq**, Kryetare i Komunës së Mitrovicës së Veriut<br><br>**Nedzad Ugljanin,** Kryesues i Kuvendit të Komunës | |
| Kopje: | **Elbert Krasniqi,** Minister në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>**Jeton Qela**, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal<br><br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | |
| Përmes: | **Avni Zogiani**, Zv. Minister në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve<br><br>**Arton Ahmeti**, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | |
| Nga: | **Bora Duli**, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve | Datë: 19.05.2025 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor<br><br>2.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor | <br><br>**Medina Millaku**, Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.<br><br>**Kimete Zekaj**, Udhëheqëse e Divizonit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve. | <br><br>Referencë: 72/2025 |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Mitrovicës së Veriut | |
| Lloji i aktit: | **Rregullore** | |

I nderuari Kryetar z.Atiq
I nderuar Kryesues z.Ugljanin,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

| |
|---|
| ***Vendimi nr.10-030/01-0006800/25 për miratimin e rregullores komunale nr.06/2025 për taksat, tarifat, dhe gjobat komunale*** |
| ***I miratuar më datë 30.04.2025*** |
| ***I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 30.04.2025*** |
| ***I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 15.05.2025*** |

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Mitrovicës së Veriut, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Mitrovicës së Veriut, me anë të vendimit që është subjekt i shqyrtimit, synon miratimin e rregullores komunale nr.06/2025 për taksat, tarifat, dhe gjobat komunale.

2. Gjatë marrjes së këtij vendimi, komunat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, si dhe Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.

3. Me relevancë për shtjellimin e kësaj çështje, Kreu II i Ligjit nr. 03/l-049 për Financat e Pushtetit Lokal ka përcaktuar se është në diskrecion të komunave që të vendosin lirshëm në lidhje me përcaktimin e taksave komunale dhe në rast të përcaktimit të tyre, kjo duhet të bëhet përmes rregulloreve komunale. Për ilustrim, Neni 10 paragrafi 1 i Ligjit, ka paraparë si në vijim:

***Neni 10***

***Taksa për Lejen për Ushtrimin e Veprimtarisë Afariste***

*10.2 Përmes një rregulloreje komunale, komuna mund të përcaktojë një taksë vjetore e cila duhet të paguhet nga shoqëritë e regjistruara tregtare për marrjen ose mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Rregullorja e sipërpërmendur mund të vendosë një skemë tarifore e cila përcakton taksa të ndryshme për kategoritë e ndryshme të veprimtarive afariste. Të gjitha taksat për marrjen e lejes 7 për ushtrimin e veprimtarisë afariste duhet të caktohen vetëm në bazë të rregullave të përcaktuara në rregulloren komunale. Skema tarifore dhe rregullat nuk duhet të përcaktojnë taksa të ndryshme për shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtari të njëjtë ose të ngjashme afariste.*

4. Për shkaqe të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, taksat komunale konsiderohen të hyra vetanake të komunës. Këto të hyra në bazë të nenit 6 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, autorizohen për shpenzim vetëm pasi ato të depozitohen në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen me kohë në SIMFK.

5. **Si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve evidenton se Rregullorja nr.06/2025 për taksat, tarifat, dhe gjobat komunale e komunës së Mitrovicës së Veriut është nxjerrur konform legjislacionit në fuqi.**

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Mitrovicës së Veriut, dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

***Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve***

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQESISE, PYLLTARISE DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralna Arhiva - Central Archive
Nr./Br./No. 1826/12
Nr. i fq./Br. Str./No. pg. 2
Data/Datum/Date. 20.05.2025
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Departamenti Ligjor/Pravni Departament/ Legal Departament**

| | | |
|---|---|---|
| **PËR:** | Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL<br>Erblin Hetemi Udhëheqës i Departamentit Ligjor në MAPL<br>Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>Ramadan Potera, Zyrtare për Monitorim të Komunave | |
| **KOPJE:** | Erden Atiq, Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore<br>Nedzad Ugljanin, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës Veriore | |
| **Cc:** | Faton Peci, Ministër ne detyrë i MBPZHR-së | |
| **PËRMES:** | Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme ne MBPZHR-së | |
| **NGA:** | Shefki Zeqiri, Drejtor i Departamentit Ligjor, MBPZHR | Datë: 12.05.2025<br>Ref.10.1.73/25 |
| **Zyrtarët përgjegjës:**<br>**1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor**<br>**2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor** | Isah Rudaku, Udhëheqës i Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit – Departamenti Ligjor - MBPZHR | |
| **Lënda:** | Përgjigje në Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së Rregullores Nr.06/2025 së Komunës së Mitrovicës Veriore | |
| **Lloji i aktit:** | Rregullore Komunale Nr.06/2025 për Taksa, Tarifa dhe Gjobat Komunale | |

I/e nderuar Kryetar,
I/e nderuar Kryesues,

Duke u bazuar në Kërkesën e MAPL të datës 15.05.2025, VI-43-261 për shqyrtimin e ligjshmërisë së Rregullores Komunale Nr.06/2025 për Taksa, Tarifa dhe Gjobat Komunale, ju informojmë me sa vijon:

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Rregullores (QRK) - Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, më datën 15.05.2025 e ka pranuar nga MAPL aktin e miratuar nga Komuna e Mitrovicës Veriore i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të

Komunës së Mitrovicës Veriore - Rregulloren Komunale Nr.06/2025 për Taksa, Tarifa dhe Gjobat Komunale të miratuar me datën 30.04.2025, e parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 30.04.2025.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 2 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, **konfirmon**:

**Shqyrtimi i Ligjshmërisë së Aktit**

Bazuar në nenin 22 të Rregullores Komunale Nr.06/2025 për Taksa, Tarifa dhe Gjobat Komunale, të miratuar me datën 30.04.2025 dhe e parashtruar për shqyrtim në MAPL, me datën 30.04.2025, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari, **konstaton se Rregullorja është në pajtim me legjislacionin ne fuqi** sepse i ka përfshi të gjitha taksat për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private dhe taksat për shfrytëzimin e kullotave.

**Arsyetim**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konstaton se ne bazë të nenit 22 të Rregullores Komunale Nr.06/2025 për Taksa, Tarifa dhe Gjobat Komunale e aprovuar me Vendim Nr.10-030/01-0006800/25 dhe e nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës Veriore me datën 30.04.2025, i ka të përcaktuara taksat në përputhje me nenin 14 të Udhëzimit Administrativ Nr.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore,të datës 27.12.2006, nenin 6 të Udhëzimit Administrativ MA-NR.12/2005 për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore-drunore, jo drunore dhe shërbime profesionale teknike, të datës 16 maj 2005, dhe taksat për kullosa në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ MA-NR..09/2007 për shfrytëzimin e kullotave të datës 30.03.2007

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konstaton se akti i Komunës së Mitrovicës Veriore – Rregullorja Komunale Nr.06/2025 për Taksa, Tarifa dhe Gjobat Komunale e aprovuar me Vendim Nr. 10-030/01-0006800/25 e miratuar me datën 30.04.2025 **është në pajtim me legjislacionin në fuqi.**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mbetet në dispozicion të komunës dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me ketë vlerësim.

*Me respekt,*

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME/MINISTARSTVO UNUTRASNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
Drejtoria e Gjendjes Civile
Direkcija Civilnog Stanja
Directorate of Civil Status
Nr/Br/No. 02 Nr. i lig./Br.str./No. pg. 129
Data/Datum/Date 22.05.2025
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME/MINISTARSTVO UNUTRASNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
Departamenti Ligjor / Pravni Departman / Legal Department
Nr/Br/No. 137 Nr. i lig./Br.str./No. pg.
Data/Datum/Date 22.05.2025
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada – Government*
**Ministria e Punëve të Brendshme**
**Ministarstvo Unutrasnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs**

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME-MINISTARSTVO UNUTRASNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the Secretary General
Nr/Br/No. 706 Nr.i./Br.str./No.pg. 1
Data/Datum/Date 23.05.2025
PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA

*Departamenti Ligjor – Pravni Departament – Legal Department*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Erblin HETEMI<br>Udhëheqës i Departamentit Ligjor në MAPL<br><br>Jeton QELA<br>Sekretarit i Përgjithshëm në MAPL | |
| Kopje: | Kryetarit të Komunës së Kaçanikut<br>Kryesuesi i KK- Kaçanik<br>Njësia për Administratën e Dokumenteve në MAPL | |
| Përmes: | Fahrije TËRNAVA-SHEREMETI<br>Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme | |
| Nga: | Naim SHALA<br>Drejtor i Departamentit Ligjor - Ministria e Punëve të Brendshme | 22.05.2025 |
| Zyrtarët përgjegjës:<br><br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br><br>2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | <br><br>Sebahate BARDHI<br>Udhëheqëse e Sektorit të Verifikimit /Drejtorati i Gjendjes Civile<br><br>Merita VISOKA<br>Zyrtare DGJC/ARC | |
| Lënda: | Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Mitrovicës Veriore | |
| Lloji i aktit: | ☐ Statut i komunës<br>☐ Rregullore komunale<br>☒ Vendim i Kuvendit të Komunës<br>☐ Akt tjetër i komunës: ________ | |

I nderuar Kryetar i Komunës,

I nderuar Drejtor,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike, Ligjin Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin në vijim "MPB") ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Emri i aktit: Vendimin nr.10-030/01-0006800/25 për miratimin e rregullorës komunale nr.06/2025 për taksa, tarifat dhe gjobat komunale |
| I miratuar më datë: 30.04.2025 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.04.2025 |
| I dërguar për shqyrtim në MPB më datë: 15.05.2025 |

Ministria e Punëve të Brendshme, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se Rregullorja e Komunës është në harmoni për aq sa obligoheni me Ligjin Nr.04/L- 003 për Gjendjen Civile të MPB-së për të ju nënshtruar vlerësimit të ligjshmërisë.

**Arsyetim**

Legjislacioni relevant në fuqi që ka për qëllim rregullimin, kuptimin dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve të Kosovës, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Kosovës, përcaktimin e rregullave për krijimin, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimin dhe funksionimin e shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Kosovës.

Konkretisht, Vendimin nr.10-030/01-0006800/25 për miratimin e rregullorës komunale nr.06/2025 për taksa, tarifa dhe gjobat komunale, rregullon për aq sa obligoheni me Ligjin Nr.04/L- 003 për Gjendjen Civile të MPB-së.

Ministria e Punëve të Brendshme mbetet në dispozicion të Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

***Qeveria - Vlada - Government***

***Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë***
***Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine***
***Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade***

Nr/Br/No 2445/04
Data/Datum/Date 23.06.2025
PRISHTINË

| | |
|---|---|
| **Për:** | Erden Atiq – Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Veriut<br><br>Nedzad Ugljanin - Kryesues i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut |
| **Kopje:** | Jeton Qela - Sekretar i Përgjithshëm në MAPL<br>Erblin Hetemi - Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave |
| **Përmes:** | Samire Ademi Zefaj, U.d. Sekretare e Përgjithshme |
| **Nga:** | Lulzim Kadriu, U.d. Drejtor i Departamentit Ligjor<br>Për: |
| **Lënda :** | Shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut |
| **Lloji i aktit:** | Rregullore Komunale Nr.06/2025 për taksat, tarifat dhe gjobat komunale |
| **Datë:** | 23.06.2025 |

I/e nderuar Kryetar,

I/e nderuar Kryesues,

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 81 paragrafi 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren (QRK) nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka pranuar kërkesën Nr.43-261/1 datë 15.05.2025

për vlerësim të ligjshmërisë të vendimit Nr.10-030/01-0006800/25 për miratimin e Rregullores Komunale Nr.06/2025 për taksat, tarifat dhe gjobat komunale i miratuar me datë 30.04.2025 nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore, dhe pas shqyrtimit të Rregullores, jap arsyetimin si në vijim.

**ARSYETIM**

Bazuar në legjislacionin e lartë përmendur dhe legjislacionit të fushë veprimtarisë së Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës për shqyrtimin e ligjshmërisë të vendimit Nr.10-030/01-0006800/25 për miratimin e Rregullores Komunale Nr.06/2025 për taksat, tarifat dhe gjobat komunale i miratuar me datë 30.04.2025 nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore, konstatojmë se Rregullorja e lartë cekur nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi e as me ndonjë akt nënligjor tashmë të miratuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë.

Me respekt,

8-1883 DALJE Data Datum Date 16 05 25
1

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria –Vlada-Government**

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/*
*Ministarstvo Obrazovanja i Nauke,Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretar/Office of the General Secretary

| | |
|---|---|
| **REFERENC-Ë:** | 16.05.2025 |
| **PËR/ZA/TO:** | Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Mitrovicës Veriore |
| **CC:** | Jeton Qelaj, Sekretar i përgjithshëm në MAPL<br>Erblin Hetemi, Udhëheqës i departamentit në MAPL |
| **PËRMES/PREKO/THROUG:** | Fadile Dyla, sekretare e përgjithshëm/MASHTI |
| **NGA/OD/FROM:** | Nazmije Maxhuni, zyrtare e lartë ligjore/MASHTI<br>Elhame Shabani, zyrtare e lartë ligjore/MASHTI |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | Përgjigje për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Mitrovicës Veriore |

Të nderuar,

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Mitrovices Veriore, Rregulloren Nr.06/2025 për taksa, tarifat dhe gjobat komunale i miratuar me dt. 30.04.2025.

Rregullorja Nr.06/2025 për taksa, tarifat dhe gjobat komunale i miratuar me dt. 30.04.2025 konkretisht nenin 15 të saj, në pjesën e ligjit të përmendur nga Ju tani është i shfuqizuar me Ligjin nr. 08/L-153 për edukimin në fëmijërinë e hershme, ndërsa sa i përket tarifës së përcaktuar për dëftesa dhe diploma dublifikatë është në harmoni me Udhëzimin administrativ 03/2013, poashtu e tarifat e përcaktuara për arsimin dhe aftësimit profesional për të rritur është në harmoni me Rregulloren nr. 01/2017 për planifikimin dhe shpenzimet e të hyrave vevetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur.

Me respekt!

**Vendimi nr. 10-030/01-0006800/25 për miratimin e rregullores komunale nr. 06/2025 për taksat, tarifat dhe gjobat komunale, miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës Veriore, datë 30.04.2025**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (MMPHI) në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 15.05.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ( MAPL) Vendimin nr. 10-030/01-0006800/25 për miratimin e rregullores komunale nr. 06/2025 për taksat, tarifat dhe gjobat komunale, miratuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës Veriore, datë 30.04.2025

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim më Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave konstaton:

**Fusha e Agjencisë Kadastrale të Kosovës**

Duke u bazuar në nenin 21 "Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë" është në përputhje me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 04/2024 për Tarifat për Produktet Shërbimet Kadastrale Gjeodezike dhe Regjistrimit të Pronave dhe Vendimin nr.53/24 të datës 02.08.2024 i nxjerr nga Agjencia Kadastrale e Kosovës për caktimin e Listës së produkteve dhe shërbimeve që ofrohen nga Zyret Kadastrale Komunale.

**Fusha e Ndërtimit**

Taksat administrative të aplikuara në këtë Rregullore nga Komuna e Mitrovicës Veriore janë të njëjtat të cilat Ministria ka dhënë pëlqimin dhe në këtë aspekt Rregullorja në fjalë është në rregull.

**Fusha e Mjedisit**

Sa i përket çështjes së tarifave për leje mjedisore rregullorja është në harmoi me Udhëzimin Administrativ, nr. 01/2017 për dhënien e lejes mjedisore komunale.